



Termet e Referencës

Titulli i ekspertizës: Ekspert/e Kërkimi dhe Analize Ligjore mbi Vendimet Gjyqësore dhe Vendimet e Organeve të Pavarura nga një Perspektivë Lesbike-Feministe

Organizata zbatuese: Aleanca Kundër Diskriminimit LGBT (Aleanca LGBT)

Kohëzgjatja/Ngarkesa: 20 ditë pune

Vendi: Punë në distancë me takime periodike sipas nevojës

Raportimi: Ekspertes Ligjore / Menaxheres së Projektit

1. Sfondi:

Gratë lesbike, biseksuale dhe transgjimore (L*BT) në Shqipëri përballen me forma të ndërthurura të diskriminimit, dhunës, përjashtimit social dhe pengesave në aksesin në drejtësi. Megjithatë kuadri ligjor shqiptar përfshin garanci të rëndësishme në fushën e barazisë dhe mosdiskriminimit, zbatimi i tyre në praktikë mbetet i kufizuar dhe shpesh i pabarabartë.

Në shumë raste, vendimet gjyqësore dhe vendimet e institucioneve të pavarura nuk adresojnë në mënyrë të plotë dimensionet gjinore dhe strukturore të diskriminimit ndaj grave L*BT. Për më tepër, mungon një analizë sistematike e praktikës ekzistuese gjyqësore dhe të institucioneve të pavarura për të identifikuar tendencat, boshllëqet, standardet pozitive dhe nevojat për përmirësim të standardeve të aplikuara në vendimarrje.

Në këtë kuadër, Aleanca LGBTI synon të angazhojë një ekspert/e kërkimi dhe analize ligjore për të zhvilluar një rishikim të thelluar nga pikëpamja lesbike dhe feministe të vendimeve të përzgjedhura gjyqësore dhe vendimeve të organeve të pavarura, me fokus në diskriminimin, dhunën, aksesin në shërbime, të drejtat familjare, njohjen ligjore dhe çështje të tjera relevante për gratë L*BT.

2. Qëllimi:

Qëllimi i kësaj ekspertize është të zhvillojë një analizë të thelluar dhe të strukturuar të vendimeve gjyqësore dhe vendimeve të organeve të pavarura nga një perspektivë lesbike-feministe dhe e të drejtave të njeriut.



Analiza synon të:

- Identifikojë tendencat kryesore në trajtimin gjyqësor dhe institucional të rasteve që prekin gratë L*BT.
- Evidentojë boshllëqet në arsyetimin juridik, mbrojtjen procedurale dhe zbatimin e standardeve të barazisë.
- Vlerësojë masën në të cilën institucionet marrin në konsideratë diskriminimin e shumëfishtë dhe barrierat strukturore.
- Identifikojë praktika pozitive dhe standarde që mund të përdoren për avokim, ngritje kapacitetesh dhe reformë ligjore.
- Hartojë rekomandime konkrete për institucionet publike, organet e drejtësisë dhe organet e pavarura.

3. Detyrat kryesore:

- Zhvillimi i metodologjisë së analizës në konsultim me ekspertin ligjor të Aleancës LGBTI.
- Identifikimi dhe përzgjedhja e vendimeve relevante gjyqësore dhe vendimeve të organeve të pavarura.
- Mbledhja, organizimi dhe sistematizimi i rasteve sipas tematikave.
- Analiza e rasteve nga një perspektivë lesbike-feministe, gjinore dhe e të drejtave të njeriut.
- Evidentimi i boshllëqeve, praktikave problematike dhe standardeve pozitive.
- Hartimi i një raporti analitik final me gjetje, analiza dhe rekomandime.
- Pjesëmarrja në takime koordinuese me ekipin e projektit për diskutimin e metodologjisë, gjetjeve paraprake dhe versionit final të raportit.

4. Produktet e ekspertizës:

- Metodologjia dhe struktura e analizës.
- Lista e rasteve dhe vendimeve të përzgjedhura për analizë.
- Matrica ose baza e të dhënave me informacionin kryesor për secilin rast.
- Raporti analitik final me gjetje dhe rekomandime.

5. Kualifikimet:

- Diplomë e avancuar në drejtësi, të drejta të njeriut, studime gjinore ose fusha të ngjashme.
- Minimumi 5 vite eksperiencë profesionale në kërkim ligjor, analizë jurisprudence dhe hartim raportesh.
- Njohuri të forta mbi të drejtat e grave, të drejtat e personave LGBTI, diskriminimin e shumëfishtë dhe standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.



ALEANCA LGBTI



Co-funded by
the European Union

- Eksperiencë në analizimin e vendimeve gjyqësore, vendimeve të institucioneve të pavarura ose praktikës administrative.
- Eksperiencë e mëparshme në përdorimin e qasjeve feministe, gjinore ose interseksionale në kërkim dhe analizë.
- Aftësi shumë të mira analitike, kërkimore dhe të shkrimit profesional.
- Njohuri shumë të mira të gjuhës shqipe dhe angleze.

6. Si të aplikoni:

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë:

- CV të përditësuar.
- Shprehje Interesi (1 faqe, duke përfshirur përvojën relevante dhe qasjen e propozuar për ekspertizën).
- Një shembull të mëparshëm të një raporti, analize ligjore ose publikimi të ngjashëm.

Aplikimet duhet të dërgohen me email në: aleanca.al@gmail.com me subjektin:
“Aplikim: Ekspert/e Kërkimi dhe Analize Ligjore mbi Vendimet Gjyqësore dhe Vendimet e Organeve të Pavarura”

Afati i aplikimit: 15 Prill 2026